

UDHËZIM
Nr. 10, datë 9.7.2012

MBI RREGULLAT NË TRANSPORTIN HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE DHE TË BAGAZHEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”;

Duke adaptuar rregulloren nr. 1371/2007 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2007 “Mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtarëve që lëvizin me hekurudhë”;

Me qëllim rregullimin, disiplinimin, monitorimin, transparencën e veprimtarisë së ushtruar nga personat juridikë në fushën e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve, si edhe integrimin gradual të këtij transporti në tregun rajonal dhe europian të transportit hekurudhor, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit nxjerr këtë udhëzim.

KAPITULLI I PARË
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Ky udhëzim përcakton rregullat e detajuara lidhur me:
- a) organizimin dhe drejtimin e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve;
 - b) informacionet që duhet të ofrojnë transportuesit hekurudhorë, përfundimi i kontratave të transportit, lëshimi i biletave dhe zbatimi i një sistemi informacioni dhe rezervimi për transportet hekurudhore;
 - c) përgjegjësinë e transportuesve hekurudhorë dhe detyrimet e tyre të sigurimit për udhëtarët dhe bagazhet e tyre;
 - ç) detyrimet e transportuesve hekurudhorë kundrejt udhëtarëve në rast vonese të trenit;
 - d) mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar që udhëtojnë me tren dhe ndihma ndaj këtyre personave;
 - dh) përcaktimin dhe monitorimin e standardeve të cilësisë së shërbimit, administrimin e rreziqeve për sigurinë personale të udhëtarëve, si dhe trajtimin e ankesave;
 - e) rregullat e përgjithshme për zbatimin.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet në të gjithë sistemin hekurudhor shqiptar për të gjitha udhëtimet hekurudhore dhe shërbimet hekurudhore të ofruara nga një apo më shumë transportues hekurudhorë të licencuar në përputhje me rregulloren e licencimit të transportuesve hekurudhorë (rregullorja e ministrit nr. 2638, datë 10.6.2011, Fletorja Zyrtare nr. 96, faqe 3922).

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për shërbimet e transportit dhe për transportuesit hekurudhorë, që nuk janë të licencuar sipas rregulloreve të ministrit të cituar në pikën 1, të këtij neni.

3. Ky udhëzim nuk zbatohet për shërbimet hekurudhore qytetëse dhe rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve dhe bagazheve.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij udhëzimi me termin:

1. “Transportues hekurudhor” kuptohet çka është përkufizuar në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

2. “Transportues” kuptojmë një transportues hekurudhor kontraktues, me të cilin udhëtari ka

përfunduar kontratën e transportit ose një seri të transportuesve hekurudhorë të njëpasnjëshëm, të cilët janë përgjegjës në bazë të kësaj kontrate.

3. “Transportues zëvendësues” kuptojmë një transportues hekurudhor që nuk ka përfunduar kontratën e transportit me udhëtarin, por të cilit transportuesi hekurudhor, palë e kontratës, i ka besuar, në tërësi ose pjesërisht, kryerjen e transportit hekurudhor.

4. “Administrues i infrastrukturës” kuptojmë çka është përkufizuar në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.

5. “Administrues i stacioneve” kuptojmë një njësi organizative në sistemin hekurudhor, i ngarkuar me administrimin e stacioneve hekurudhore, i cili mund të jetë edhe administruesi i infrastrukturës.

6. “Shitës bilete” kuptojmë çdo shitës me pakicë të shërbimeve të transportit hekurudhor që ka kontratë dhe shet bileta në emër të një transportuesi hekurudhor ose për llogari të vet.

7. “Kontrata e transportit” kuptojmë një kontratë transporti me ose pa pagesë ndërmjet një transportuesi hekurudhor ose një shitësi biletash dhe udhëtarit për ofrimin e një ose më shumë shërbimeve të transportit.

8. “Rezervim” kuptojmë një autorizim, në letër apo në formë elektronike, që i jep të drejtë transporti udhëtarit në trenin dhe vendin që ai ka rezervuar.

9. “Biletë direkte” kuptojmë një ose shumë bileta që përfaqësojnë një kontratë transporti, për shërbime hekurudhore të njëpasnjëshme, të ofruara nga një ose shumë transportues hekurudhorë.

10. “Shërbim hekurudhor i brendshëm i transportit të udhëtarëve” kuptojmë një shërbim hekurudhor i transportit të udhëtarëve në kuadrin e të cilit treni nuk kalon kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

11. “Vonesë” kuptojmë ndryshimin e kohës ndërmjet orës që udhëtari duhet të mbërrinte sipas grafikut të publikuar dhe orës së mbërritjes reale ose të parashikuar.

12. “Abone” kuptojmë një biletë për një numër të kufizuar udhëtimesh, që lejon mbajtësin e autorizuar që të udhëtojë me hekurudhë në një itinerar të caktuar ose në një rrjet të veçantë gjatë një periudhe të përcaktuar.

13. “Sistem i informacionit dhe rezervimit për transportin hekurudhor” kuptojmë një sistem që përmban informacione mbi shërbimet hekurudhore të ofruara nga transportuesit hekurudhorë.

Informacionet lidhur me shërbimet për udhëtarët të grumbulluara në këtë sistem duhet të përfshijnë informacione mbi:

- a) kalendarin dhe oraret e shërbimeve të udhëtarëve;
- b) disponueshmërinë e vendeve të shërbimeve të udhëtarëve;
- c) tarifatat dhe kushtet e veçanta;
- ç) mundësinë e hyrjes në trena të personave me aftësi të kufizuar dhe të personave me lëvizshmëri të reduktuar;

d) pajisjet me anë të të cilave mund të bëhen rezervimet ose të jepen bileta udhëtimi, për aq sa një pjesë ose të gjitha këto pajisje janë në dispozicion të përdoruesit.

Sistemi i informacionit dhe i rezervimit për transportin hekurudhor mund të jetë edhe i informatizuar.

14 “Person me aftësi të kufizuara” ose “person me lëvizshmëri të reduktuar” kuptojmë çdo person, lëvizshmëria e të cilit është e kufizuar gjatë përdorimit të një mjeti transporti për arsye të ndonjë paaftësie fizike të tij (shqisore ose lëvizëse, e përhershme ose e përkohshme) ose të çdo paaftësie, ose dëmtimi intelektual, ose të çdo shkakut tjetër të paaftësisë apo si rezultat i moshës, dhe gjendja e të cilit kërkon vëmendjen e duhur dhe përshtatjen e nevojave të tij.

15. “Kushtet e përgjithshme të transportit” kuptojmë kushtet e transportuesit në formën e kushteve të përgjithshme ose të tarifave ligjërish të zbatueshme në sistemin hekurudhor shqiptar dhe që, me përfundimin e kontratës së transportit, bëhen pjesë përbërëse e tij.

16. “Mjet” kuptojmë një mjet tërheqës ose një vagon që lëviz për kryerjen e transportit të udhëtarëve.

KAPITULLI II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E UDHËTARËVE NË TRANSPORTIN HEKURUDHOR

Neni 4

Kontrata e transportit, informacioni dhe biletat

1. Bileta e transportit përbën lidhjen dhe përmbajtjen e kontratës së transportit ndërmjet udhëtarit dhe transportuesit hekurudhor. Ky i fundit merr përsipër dërgimin e udhëtarit në destinacionin e përcaktuar në biletë, sipas grafikut të lëvizjes së publikuar.

2. Sipas dispozitave të këtij udhëzimi, përfundimi dhe realizimi i kontratës së transportit kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil dhe të Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Përfundimi dhe kushtet e kufizimeve

1. Detyrimet ndaj udhëtarëve që rezultojnë nga ky udhëzim nuk mund të bëhen objekt i një kufizimi ose i një përfundimi.

2. Transportuesit hekurudhorë mund të ofrojnë kushte kontraktuese më të favorshme për udhëtarët se kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 6

Detyrimi i informimit lidhur me ndërprerjen e shërbimeve

Transportuesit hekurudhorë ose, nëse duhet, autoritetet kompetente përgjegjëse për një kontratë hekurudhore të shërbimit publik duhet të publikojnë vendimet e ndërprerjes së shërbimeve me anë të mjeteve të përshtatshme dhe para zbatimit të tyre.

Neni 7

Informacione mbi udhëtimet

1. Transportuesit hekurudhorë dhe shitësit e biletave, duke ofruar biletat e udhëtimit në emër të një ose më shumë transportuesve hekurudhorë u japin udhëtarëve para udhëtimit, me kërkesën e tyre, të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e përgjithshme të zbatimit të kontratës;
- b) oraret dhe kushtet për një udhëtim më të shpejtë;
- c) oraret dhe kushtet për tarifën më të ulët;
- ç) mundësinë, kushtet e hyrjes dhe të disponibilitetit në tren të pajisjeve për personat me aftësi dhe lëvizshmëri të kufizuara;
- d) mundësinë dhe kushtet e hyrjes së biçikletave;
- dh) mundësinë e vendeve të qëndrimit në zonat që pihen ose jo duhan, në klasin e parë dhe të dytë, vendet e fjetjes në vagonët për fjetje;
- e) aktivitetet që mund të ndërpresin ose të vonojnë shërbimet;
- ë) disponibilitetin e shërbimeve në bordin e trenave;
- f) procedurat e reklamimit të bagazheve të humbura;
- g) procedurat e depozitimit të ankesave;

2. Transportuesit hekurudhorë u sigurojnë udhëtarëve gjatë udhëtimit të paktën informacionet e mëposhtme:

- a) shërbimin që ofrohet në bordin e trenave;
- b) stacionin vijues;
- c) vonesat;
- ç) korrespondencat kryesore;
- d) çështjet që lidhen me sigurinë.

3. Informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni ofrohet në formën më të përshtatshme. Vëmendje e veçantë në këtë drejtim duhet t'u kushtohet personave që janë me dëmtime të shikimit ose të dëgjimit.

Neni 8

Vlefshmëria e biletave dhe rezervimet

1. Transportuesit hekurudhorë dhe shitësit e biletave ofrojnë bileta udhëtimi dhe bëjnë rezervime.
2. Pa cenuar pikën 3 të këtij neni, transportuesit hekurudhorë shpërndajnë biletat për udhëtarët me të paktën në një nga mënyrat e mëposhtme të shitjes:
 - a) sportelet ose makinat automatike;
 - b) telefonit, internetit apo çdo teknologjie tjetër e përdorur gjerësisht;
 - c) në trena gjatë lëvizjes.
3. Transportuesit hekurudhorë ofrojnë mundësinë për të marrë bileta për shërbimin përkatës në bordin e trenit, vetëm nëse kjo mundësi kufizohet ose refuzohet në vendet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për arsye që lidhen me sigurinë ose luftën kundër mashtrimit, të arsyeve të rezervimit të detyrueshëm të trenit apo për shkaqe të arsyeshme tregtare.
4. Kur në stacionin e nisjes nuk ka zyrë ose makinë për të shitur bileta, atëherë udhëtarët duhet të informohen në stacionin e nisjes lidhur me procedurën e blerjes së biletave.

Neni 9

Përgjegjësia e transportuesve hekurudhorë për udhëtarët dhe bagazhet e tyre

Përgjegjësia e transportuesve hekurudhorë në lidhje me udhëtarët dhe bagazhet e tyre, si dhe kompensimet e mëtejshme për dëmet ndaj tyre në rastin e:

- a) vdekjes apo plagosjes nga aksidentet apo incidentet;
- b) vonesën e trenave, korrespondencën e munguar, anulimin e trenave, ndërprerjen e udhëtimit;
- c) kompensimin e çmimit të biletave;
- ç) kompensimin e vonesave;
- d) siguracioni i udhëtimit;

rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil dhe Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10

Asistenca ndaj udhëtarëve

1. Në rastin e një vonese në mbërritje ose në nisje, transportuesit hekurudhorë ose administruesit e infrastrukturës informojnë udhëtarin për situatën, si dhe për orën e nisjes apo të mbërritjes të parashikuar nëse këto informacione ai i disponon.

2. Në rast se treni është bllokuar në perigon ose në stacionin hekurudhor, udhëtarëve u ofrohet transporti me tren nga vendndalimi i trenit deri në pikën e nisjes apo në stacionin e destinacionit final të shërbimit, nëse kjo është e mundur.

3. Nëse shërbimi hekurudhor nuk mund të vazhdohet më, transportuesit hekurudhorë do të organizojnë sa më shpejt të jetë e mundur shërbimet alternative të transportit të udhëtarëve.

4. Transportuesi hekurudhor, me kërkesë të udhëtarit, vërteton në biletë se shërbimi hekurudhor për të cilin ai ka marrë biletë direkte ka pësuar një vonesë, ka çuar në një lidhje të humbur ose që është anuluar.

5. Në zbatimin e paragrafëve 1, 2 dhe 3, transportuesit hekurudhorë në fjalë u kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të personave me aftësi të kufizuar dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar dhe çdo personi që i shoqëron ata.

Neni 11

E drejta për të transportuar personat me aftësi të kufizuar dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar

1. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve hartojnë dhe zbatojnë rregulla për pjesëmarrjen e padiskriminuar në transport të personave me aftësi të kufizuar dhe të personave me lëvizshmëri të reduktuar, duke u konsultuar me organizatat që i përfaqësojnë ata.

2. Transportuesi hekurudhor dhe shitësi i biletave nuk mund të refuzojnë një rezervimin ose shitjen e një biletë për një person me aftësi të kufizuar, ose një personi me lëvizshmëri të reduktuar. Në vartësi të kushteve specifike ata mund të kërkojnë që personi i tillë të shoqërohet nga një person tjetër.

3. Me kërkesë, një transportues hekurudhor apo një shitës biletash duhet t'u sigurojë personave me

aftësi të kufizuar dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar informacion mbi mundësinë e shërbimeve hekurudhore, si dhe kushtet e hyrjes në mjetet lëvizëse.

4. Kur një transportues hekurudhor ose shitësi i biletave nuk mund të zbatojë rregullat e parashikuara në këtë nen, ata duhet të informojnë me shkrim personin me aftësi të kufizuar apo personin me lëvizshmëri të reduktuar për arsyet në fjalë, brenda pesë ditëve pune nga refuzimi për të bërë rezervimin ose për të dhënë biletën, ose imponimi për të qenë i shoqëruar.

5. Pa prekur rregullat që i referohen këtij neni transportuesit hekurudhorë duhet t'u sigurojnë personave me aftësi të kufizuar dhe personave me lëvizshmëri të reduktuar ndihmë falas në bordin e një treni dhe gjatë hipjes në tren dhe zbritjes nga treni.

Neni 12

Siguria e udhëtarëve

Transportuesit hekurudhorë, administruesit e infrastrukturës dhe administruesit e stacioneve marrin masat e duhura sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë për të garantuar lëvizjen e sigurt të udhëtarëve në stacionet hekurudhore dhe në trena dhe për të administruar rreziqet. Ata bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacione për praktikatat më të mira në lidhje me parandalimin e veprimeve, të cilat mund të përkeqësojnë nivelin e sigurisë.

Neni 13

Ankesat

1. Transportuesit hekurudhorë janë të detyruar që të publikojnë procedurën për trajtimin e ankesave lidhur me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Udhëtarët mund të paraqesin ankesën tek transportuesi hekurudhor. Brenda një muaji, marrësi i ankesës, jep një përgjigje të arsyetuar mbi të gjitha çështjet e ngritura në të.

3. Transportuesi hekurudhor, në raportin vjetor që i referohet nenit të mëposhtëm, publikon numrin dhe kategoritë e ankesave të marra, ankesat e trajtuara, afatet e përgjigjeve dhe veprimet e ndërmarra për përmirësimin e situatës.

Neni 14

Standardet e cilësisë së shërbimit

1. Transportuesit hekurudhorë përcaktojnë standardet e cilësisë së shërbimit dhe zbatojnë një sistem të administrimit të cilësisë për ta ruajtur këtë cilësi. Standardet e cilësisë së shërbimit të paktën duhet të mbulojnë çështjet e mëposhtme:

- a) informacionet dhe biletat;
- b) përpikëria e shërbimeve dhe parimet e përgjithshme për të kapërcyer çrregullimet e shërbimeve;
- c) pastërtia e mjeteve lëvizëse dhe e mjediseve të stacioneve (cilësia e ajrit në vagonë, higjiena e pajisjeve sanitare etj.);
- ç) evidentimi i plotësimin të kërkesave të udhëtarëve;
- d) trajtimi i ankesave, rimbursimet, kompensimet në rastin e mosrespektimit të standardeve të cilësisë së shërbimit;

dh) asistencë në rastin e personave me aftësi të kufizuar dhe e personave me lëvizshmëri të reduktuar.

2. Transportuesit hekurudhorë monitorojnë punën e tyre sipas standardeve të cilësisë së shërbimit. Ata publikojnë çdo vit një raport vlerësimi mbi ecurinë e cilësisë së tyre të shërbimit, së bashku me raportin e tyre vjetor. Raportet mbi ecurinë e cilësisë së shërbimit publikohen në faqen e internetit të transportuesve hekurudhorë.

Neni 15

Informacione për udhëtarët mbi të drejtat e tyre

1. Kur shesin bileta për udhëtimet me hekurudhë, transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e stacionit informojnë udhëtarët për të drejtat dhe detyrimet e tyre në zbatim të këtij udhëzimi.

2. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e stacioneve informojnë udhëtarët, në stacion dhe në tren, për detajet e pikave të kontaktit lidhur ankimet për cilësinë e shërbimit.

3. Çdo udhëtar mund të ankohet te ministri ose tek organi i caktuar prej tij në lidhje me shkeljet e të drejtave të tij të përcaktuara nga ky udhëzim.

Neni 16

Te drejtat e udhëtarit në trenat e udhëtarëve

1. Gjatë udhëtimit në trena, udhëtari mund:

a) të marrë me vete bagazhe dore pa pagesë deri në 20 kg, të cilat mund të vendosen në vendin e caktuar për këtë qëllim;

b) të marrë me vete dhe t'i ketë kujdes vetë kafshë të vogla shtëpiake, të lejueshme për transportin hekurudhor;

c) të dëmshpërblehet sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast aksidenti apo incidenti, të ndodhur gjatë udhëtimit me tren.

2. Për probleme që mund t'i lindin kur është në tren, udhëtari mund t'i drejtohet personelit të trenit.

Neni 17

Detyrimet e udhëtarëve

1. Udhëtarët kanë për detyrë:

a) të pajisen me biletë udhëtimit apo me biletë bagazhi për bagazhin e tyre;

b) të ruajnë biletën e udhëtimit apo të bagazhit në gjendje të mirë deri në fund të udhëtimit dhe t'i paraqesë ato kur i kërkohet nga personeli i shërbimit dhe i kontrollit;

c) të mbajë pastër vendin e qëndrimit;

ç) të zhdëmtojë vlerën e dëmit të shkaktuar prej tij në tren apo në mjediset e stacionit;

d) gjatë kalimit të tij nga një tren tek tjetri në stacione e korrespondencës të kujdeset vetë për transferimin e bagazheve të dorës që ai mban me vete.

dh) të zbatojë rregullat e shërbimit në stacione dhe në tren gjatë udhëtimit dhe të veprojë sipas porosive të personelit të shërbimit;

e) të kujdeset vetë për hipjen në tren dhe zbritjen nga treni.

2. Udhëtarëve u ndalohet:

a) transportimi i lëndëve djegëse, plasëse, helmuese, gërryese dhe i lëndëve të tjera të kësaj natyre;

b) transportimi i gjësë së gjallë në vagonët e udhëtarëve;

c) hipja në tren pasi të jetë dhënë sinjali për nisjen e tij;

ç) prishja e qetësisë në tren dhe shqetësimi i udhëtarëve të tjerë;

d) përkulja nga dritaret, hapja e dymve të vagonit, qëndrimi në urat kaluese, në dym, shkallë e parakolpe kur treni është në lëvizje;

dh) hedhja nga vagoni e çfarëdolloj sendi;

e) ndotja e mjedisit në stacion dhe në vagon;

ë) pirja e duhanit në mjediset e palejuara;

f) përdorimi në tren i pijeve alkoolike dhe narkotike;

g) hipja dhe zbritja nga treni në vendet e paparashikuara në orarin e lëvizjes së trenave;

gj) përdorimi i frenit të sigurimit.

Neni 18

Përgjegjësi nga transporti

Udhëtarët që:

a) shkelin rregullat e përcaktuara në nenin e mëparshëm, pika "f";

b) cenojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurimit të lëvizjes së trenave;

c) me veprimet e tyre shqetësojnë rëndë udhëtarët e tjerë;

ç) shkelin rregullat e përcaktuara për rendin publik;

mund të përgjashtohen nga transporti në stacionin më të afërt.

KAPITULLI III ORGANIZIMI I TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Neni 19

E drejta për të ushtruar veprimtarinë e transportit hekurudhor të udhëtarëve

1. Të drejtën për të ushtruar veprimtarinë e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe bagazheve e kanë ata transportues hekurudhorë, të cilët janë të licencuar për kryerjen e një aktiviteti të tillë nga autoriteti përkatës i licencimit;

2. Para se të fillojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve, transportuesit hekurudhorë duhet të lidhin kontratat përkatëse me administruesit e infrastrukturës lidhur me sigurimin e rrugëkalimeve të trenave, kryerjen e pagesave të përdorimit të infrastrukturës, miratimin e grafikut të lëvizjes së trenave etj.

3. Para se të fillojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve, transportuesit hekurudhorë duhet të pajisen me certifikatën përkatëse të sigurisë nga Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor.

Neni 20

Transporti i bagazheve të dorës

1. Udhëtari, gjatë udhëtimit, mund të mund të marrë falas me vete në vagonë objekte të lehta për t'u mbajtur (bagazhe dore).

2. Çdo udhëtar ka në dispozicion për bagazhet e tij të dorës vetëm një hapësirë të vendosur mbi dhe nën vendin që ai zë ose një hapësirë tjetër korresponduese kur vagonët janë të një tipi special, sidomos kur ato përmbajnë një depo për bagazhet e dorës.

3. Nuk mund të futen në vagonë si bagazhe dore:

a) lëndët dhe objektet e rrezikshme, të përjashtuara nga transporti;

b) objektet e një natyre që shqetësojnë ose mërzhisin udhëtarët ose shkaktojnë një dëm;

c) objektet që dispozitat e doganës ose të autoriteteve të tjera administrative nuk i lejojnë që të vendosen në vagonë;

ç) kafshët e gjalla, përveç përjashtimeve të veçanta të parashikuara nga ky udhëzim.

4. Pranohen për transport, si bagazhe dore, valixhe dhe çanta udhëtimi, baule dhe shporta të vogla, të cilat lehtësisht mund të vendosen në hapësirën që është në dispozicion të udhëtarit.

Neni 21

Pranimi i bagazheve

1. Pranohen për transport si bagazhe, objekte të tilla që nuk janë bagazhe dore, nuk kanë peshë mbi 50 kg dhe nuk kanë gabarite të mëdha, me qëllim që të mund të futen në vagonët e bagazheve.

2. Përjashtohen nga transporti si bagazhe:

a) lëndët dhe objektet e rrezikshme, sidomos armët e mbushura, lëndët dhe objektet eksplozive ose që ndizen, lëndët djegëse, toksike, radioaktive ose korrozive, si dhe lëndët me erë të keqe ose infektive;

b) objektet kaba me një masë të madhe;

c) kafshët e gjalla që duan përkujdesje të vazhdueshme.

Neni 22

Dorëzimi i bagazheve në stacionin e nisjes dhe transporti i tyre

1. Udhëtari i dorëzon bagazhin punonjësit që shërben në vagonin përkatës të bagazheve të trenit të udhëtarëve;

2. Dorëzimi i bagazheve bëhet vetëm me paraqitjen e biletave të bagazheve të marra në biletaritë e shitjes së biletave, të cilat janë të vlefshme deri në destinacionin e bagazheve. Në rast se udhëtari nuk është pajisur me biletën përkatëse të bagazheve për arsye që nuk varen prej tij, atëherë punonjësi i transportuesit hekurudhor që shërben në vagonin e bagazheve e pajis atë me biletën përkatëse të bagazheve.

3. Transportuesi hekurudhor bën transferimin e bagazheve nga një tren në tjetrin në stacionet e

korrespondencës ku udhëtari ndërron tren.

4. Përveç ndonjë përjashtimi të parashikuar nga transportuesi hekurudhor, çmimi i transportit të bagazheve duhet të paguhet para fillimit të udhëtimit.

5. Transportuesit hekurudhorë mund të përjashtojnë ose të kufizojnë transportin e bagazheve në disa trena ose në disa kategori të trenave ose me destinacion dhe ardhje nga disa stacione.

6. Me marrjen e bagazhit në dorëzim, transportuesi hekurudhor është përgjegjës për transportin e sigurt të tij deri në stacionin e destinacionit.

Neni 23

Dorëzimi i bagazheve në stacionin e mbërritjes

1. Bagazhet i dorëzohen udhëtarit në stacionin e mbërritjes, pasi ai ka paraqitur kundërbiletën.
2. Mbajtësi i kundërbiletës, të cilit bagazhet nuk i janë dorëzuar konform pikës 1 të këtij neni, mund të bëjë ankimim tek transportuesi hekurudhor.
3. Udhëtari ka të drejtën e ankimit edhe në rastin kur bagazhi që ai ka dorëzuar është dëmtuar gjatë udhëtimit.

Neni 24

Pranimi i kafshëve në vagonët e udhëtarëve

1. Me qëllim sigurimin e kushteve komode në transportin e udhëtarëve, si rregull, kafshët e gjalla nuk lejohen të futen në vagonët e udhëtarëve;

2. Në vagonët e udhëtarëve mund të lejohet futja e kafshëve të vogla shtëpiake, të mbyllura në kafaz, shporta apo ambalazhe të tjera të përshtatshme, me kusht që ky transport të mos cenojë dispozitat veterinarë dhe sanitare.

Shpendët dhe kafshët e imta nuk konsiderohen si kafshë shtëpiake.

3. Qentë e vegjël mund të futen në vagon edhe nëse nuk janë të mbyllur në kafaz, me kusht që udhëtari t'i mbajë në prehër. Si qen i vogël konsiderohet ai, lartësia e të cilit, nga toka deri te kurrizi nuk kalon 40 cm.

Mbikëqyrja e kafshëve që udhëtari merr me vete në vagon i takon udhëtarit.

4. Udhëtari është përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara nga kafshët që ai merr me vete në vagon, përveç kur ai provon që dëmi është shkaktuar nga një gabim i transportuesit hekurudhor ose nga një gabim i një të treti.

Neni 25

Transporti i biçikletave

Transportuesit hekurudhorë u mundësojnë udhëtarëve transportin e biçikletave të tyre me tren në vagonin e bagazheve kundrejt një tarife, nëse ato janë të lehta për t'u trajtuar dhe nëse kjo nuk do të ndikojë negativisht në shërbimin specifik hekurudhor dhe nëse mjetet hekurudhore e lejojnë këtë shërbim.

KAPITULLI IV

DETYRAT E TRANSPORTUESVE HEKURUDHORË

Neni 26

Biletat e udhëtimit

1. Transportuesit hekurudhorë organizojnë pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi dhe bileta bagazhesh. Shitja e biletave të tilla mund t'u delegohet edhe agjencive të udhëtimit.

2. Biletat e udhëtimit, si rregull, janë të njëjta në formë, madhësi, si dhe nga mbishkrimet mbi to.

3. Biletat e udhëtimit përmbajnë të paktën mbishkrimet e mëposhtme:

- a) stacionin e nisjes dhe të mbërritjes;
- b) çmimin e biletës së udhëtimit;
- c) numrin rendor;
- ç) serinë e biletës;
- d) vulën e stacionit të nisjes;
- dh) datën e udhëtimit;
- e) primin e sigurimit të detyrueshëm të udhëtarit;
- ë) siglën e transportuesit hekurudhor.

Mbishkrimet e parashikuara në germat “a”, “d” dhe “dh” mund të vendosen me vulën datare të stacionit të nisjes.

4. Biletat e bagazheve përmbajnë të paktën mbishkrimet e mëposhtme:

- a) stacionin e nisjes dhe të mbërritjes;
- b) peshën;
- c) çmimin e udhëtimit;
- dh) numrin rendor të biletës;
- e) vulën e stacionit të nisjes;
- ë) datën e udhëtimit;
- f) siglën e transportuesit hekurudhor.

5. Biletat e udhëtimit në transportin e udhëtarëve dhe bagazheve brenda vendit shtypen në gjuhën shqipe, ndërsa biletat për transportin ndërkombëtar shtypen edhe në një gjuhë të huaj, për të cilën është rënë dakord paraprakisht me marrëveshjet përkatëse.

6. Në transportin hekurudhor të udhëtarëve brenda vendit përdoren tipat e mëposhtëm të biletave të udhëtimit;

- a) biletat e zakonshme për një udhëtim;
- b) biletat për udhëtimet vajtje-kthim;
- c) bileta abone për 10 ditë pune për punonjës apo studentë;
- ç) bileta për udhëtarë me tarifë të ulur, të përfituar nga ligjet përkatëse.

7. Formatet dhe tipat e biletave të udhëtimit dhe të biletave të bagazheve që përmbajnë të paktën mbishkrimet e përmendura në pikat 3 dhe 4 të këtij neni hartohen dhe miratohen nga transportuesit hekurudhorë.

Neni 27

Vulosja e biletave të udhëtimit

1. Biletat e udhëtimit vuloen si më poshtë:

- a) me makinë;
- b) me vulën me datë të stacionit;
- c) me shenjzues biletash.

Nëse shitësi i biletave nuk ka shenjzues, çdo biletë udhëtimi vuloet më vete, me vulën datare të stacionit.

Transportuesit hekurudhorë përcaktojnë rregullat dhe mbajnë përgjegjësi për procedurat e vulosjes së biletave të udhëtimit në përputhje me legjislacionin kombëtar të fushës.

2. Ndalohet dhënia e biletave të pavulosura, të vulosura dy herë ose e biletave që kanë vula të paqarta dhe të palexueshme. Këto bileta konsiderohet të parregullta.

Neni 28

Detyrat e shoqëruesit të vagonëve në trenat e udhëtarëve

1. Përveç detyrave të tjera në fushën e pajisjes me dëshmi aftësie dhe të kualifikimeve të vazhdueshme, detyrat e shoqëruesit të vagonëve gjatë shërbimit në trena janë si më poshtë:

- a) kontrollon në vazhdimësi dhe pas çdo ndalimi të trenit pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi;
- b) kujdeset që dyert e vagonit gjatë lëvizjes së trenave të jenë të mbyllura dhe të siguruara;
- c) mban vagonin të rregullt dhe të pastër;

ç) të ketë sjellje të kujdesshme me udhëtarët, të jetë i komunikueshëm dhe të jetë i gatshëm për t'u shërbyer atyre;

d) vendos rregull në hyrjen dhe daljen e udhëtarëve në vagonë, duke qëndruar vetë pranë derës për të mënjanuar çdo konfuzion dhe rrezik për ta;

dh) nuk lejon hipjen dhe zbritjen e udhëtarëve kur treni është në lëvizje;

e) nuk lejon qëndrimin e udhëtarëve në urat lidhëse ndërmjet vagonëve dhe në shkallët e tyre;

ë) u transmeton udhëtarëve informacione të plota e të sakta lidhur me grafikun e lëvizjes së trenave;

f) kujdeset për ruajtjen e komoditetit të brendshëm të vagonit që ka në ngarkim;

g) i raporton kryetarit të trenit për problemet dhe parregullsitë që evidenton gjatë udhëtimit të trenit, problemet që lidhen me pjesën e brendshme të vagonit dhe dëmtimet e mundshme;

gj) bashkëpunon me organet e policisë për të gjitha shqetësimet që kanë të bëjnë me rendin publik gjatë udhëtimit të trenave;

h) merr masat e duhura për eliminimin e parregullsive brenda mundësive të tij.

2. Transportuesi hekurudhor mund të caktojë detyra të tjera shtesë për shoqëruesin e vagonit lidhur me mirëfunksionimin e shërbimit hekurudhor të udhëtarëve.

Neni 29

Detyrat e kryetarit të trenit të udhëtarëve

1. Përveç detyrave lidhur me pajisjen me dëshmi aftësie dhe të kualifikimeve të vazhdueshme profesionale, kryetari i trenit të udhëtarëve gjatë ushtrimit të detyrës së tij, ka të paktën detyrat e mëposhtme:

a) ushtron kontroll mbi pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi dhe bileta bagazhesh;

b) kontrollon shoqëruesit e vagonëve lidhur me pajisjen e udhëtarëve me bileta udhëtimi;

c) kontrollon paraqitjen e rregullt dhe në kohën e duhur të personelit shoqërues të trenit dhe zbatimin e detyrave nga ana e tyre;

ç) kontrollon para nisjes formimin e trenit, nëse ky formim është bërë në përputhje me rregullat në fuqi;

d) kujdeset për kryerjen e kontrollit teknik të vagonëve dhe të provave të frenave në të gjitha stacionet e parashikuara;

dh) ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi funksionimin e rregullt të dyerve dhe mbylljen e tyre gjatë udhëtimit;

e) është përgjegjës për kryerjen e detyrave nga punonjësit e shërbimit në tren dhe sjelljen e rregullt ndaj udhëtarëve;

ë) verifikon dhe mbledh të dhëna për numrin e udhëtarëve sipas itinerareve të lëvizjes së trenave, si dhe evidenton sugjerimet e udhëtarëve lidhur me nivelin e shërbimit;

f) kontrollon vazhdimisht gjendjen e mjediseve të brendshme të vagonëve, cilësinë e pastrimit, furnizimin me ujë të depozitave, funksionimin e aparaturave të ndriçimit, të ventilimit, të fonisë, ndjek rregullsinë e pajisjeve dhe pjesëve të inventarit të vagonëve etj.;

g) mbledh të dhëna për trenin që lidhen me nevojat e udhëtarëve, orarin e trenave, punën e punonjësve, komfortin e udhëtimit etj.;

gj) kontrollon nëse bagazhet e pranuar për transport kanë dokumentacionin përkatës të transportit, nëse janë pranuar për transport sipas rregullave të miratuara, nëse janë sistemuar në rregull në vagon etj.;

h) në përfundim të udhëtimit përgatit informacionin përkatës lidhur me ecurinë ditore të udhëtimit, problemet e konstatuara dhe masat e marra për eliminimin e tyre.

2. Transportuesi hekurudhor mund të caktojë detyra të tjera shtesë për kryetarin e trenit lidhur me mirëfunksionimin e shërbimit hekurudhor të udhëtarëve.

KAPITULLI V

DETYRAT E ADMINISTRUESVE TË INFRASTRUKTURËS

Neni 30

Detyrat e administruesve të infrastrukturës hekurudhore

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore ka për detyrë:
 - a) krijimin e kushteve të përshtatshme dhe cilësore në mjediset e godinave të stacioneve të qëndrimit të udhëtarëve sipas standardeve të përcaktuara;
 - b) krijimin e kushteve të përshtatshme në stacione për hipjen në trena dhe daljen prej tyre;
 - c) pajisjen me peronet e domosdoshme të çdo linje të stacioneve që përdoret për shërbimet ndaj udhëtarëve;
 - ç) të pajisë stacionet e udhëtarëve me sinjalistikën dhe foninë e nevojshme;
 - d) t'u ofrojë udhëtarëve një informacion të plotë për oraret e lëvizjes së trenave, të korrespondencave, të vonesës së trenave dhe të trenave të anuluar;
 - dh) të krijojë kushtet e nevojshme të infrastrukturës hekurudhore për organizimin, drejtimin dhe lëvizjen e sigurt të trenave në stacione dhe në vijën hekurudhore;
 - e) në kushtet e konstatimit të dëmtimit të vijës hekurudhore, e cila nuk bën të mundur qarkullimin e trenave, njofton menjëherë transportuesin hekurudhor. Në këto raste merr masa të menjëhershme për riparimin e vijës hekurudhore dhe rivendosjen e lëvizjes së sigurt të trenave në një kohë sa më të shkurtër të mundshme;
 - ë) të krijojë kushtet e domosdoshme për trajtimin e barabartë, jodiskriminues dhe në kushte të njëjta të transportuesve hekurudhorë të transportit të udhëtarëve për dhënien e rrugëkalimeve dhe tarifave të njëjta të përdorimit të infrastrukturës hekurudhore;
 - f) të marrë masat e duhura për krijimin e kushteve të domosdoshme të hipjes në trena dhe të zbritjes nga treni të personave me aftësi të kufizuar dhe me lëvizshmëri të kufizuar.

KAPITULLI VI

KUALIFIKIMI I PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE

Neni 31

Pajisja e punonjësve me dëshmi aftësie

1. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë” dhe të rregulloreve dhe të udhëzimeve të dala në zbatim të tij, personeli që realizon shërbimin hekurudhor të udhëtarëve dhe pikërisht makinisti, ndihmësmakinisti, kryetari i trenit, shoqëruesi i vagonit, mekaniku kontrollor i trenit duhet të pajisen me dëshmi aftësie.
2. Transportuesit hekurudhorë dhe administruesit e infrastrukturës janë përgjegjës për aftësimin dhe riaftësimin profesional të punonjësve që realizojnë shërbimin hekurudhor të udhëtarëve.
3. Punonjësit e cituar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni merren në provë dhe pajisen me dëshmi aftësie nga një komision i veçantë pranë Drejtorisë së Inspektimit Hekurudhor.

Neni 32

Programet e aftësimin dhe të riaftësimin

Në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Kodit Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë, punonjësit përkatës të transportuesit hekurudhor që pajisen me dëshmi aftësie, realizojnë programet e aftësimin dhe të riaftësimin, të hartuara në bazë të dispozitave përkatëse në fuqi.

KAPITULLI VII

TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR I UDHËTARËVE

Neni 33

Baza ligjore e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve

Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve realizohet sipas dispozitave të:

- a) Konventës për Transportin Ndërkombëtar Hekurudhor (COTIF);

b) Rregullat uniforme në lidhje me kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve (CIV)

c) Marrëveshjeve dypalëshe shtetërore të transportit hekurudhor me vendet fqinje.

ç) Marrëveshjeve dypalëshe të lidhura në nivelin e administruesve të infrastrukturave të vendit tonë me administruesit e infrastrukturave të vendeve fqinje.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi